

V E N D I M
Nr.532, datë 24.9.2001

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 84 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3 paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në komisaritet e policisë paraqiten ata të huaj, të cilëve u skadon afati i qëndrimit me vizë, e që dëshirojnë ta zgjasin këtë qëndrim ose kërkojnë të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë mbi tre muaj, si dhe të huajt që hyjnë pa vizë e qëndrojnë më shumë se 30 ditë. Paraqitja në organet e policisë, në këto raste, bëhet jo më vonë se 10 ditë para se të mbarojë afati i vlerfshmërisë së qëndrimit të përfutur”.

2. Në pikën 9, pas paragrafit të dytë të shtohet paragrafi, që më poshtë vijon:

“Për shtetasit e huaj të cilët hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, si dhe për ata të cilët marrin vizë në kufi, kohëqëndrimi në Republikën e Shqipërisë mund të zgjatet deri në 90 ditë, duke filluar nga data e hyrjes në kufirin shqiptar”.

3. Në pikën 10 bëhen këto ndryshime:

- Në fund të shkronjës “c” të shtohen fjalët: “...ose në vendin ku i interesuari ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtëmuajin e fundit.”.

- Në shkronjën “ç”, pas fjalëve “organet policore” të shtohen fjalët që më poshtë vijojnë: “...organet të tjera të administratës shtetërore, në vendin ku i interesuari ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtëmuajin e fundit ose nga përfaqësia diplomatike a konsullore e akredituar në Republikën e Shqipërisë”.

- Në fund të pikës 10 të shtohet paragrafi që më poshtë vijon:

“Specialistët e ardhur në kuadër të marrëveshjeve, dypalëshe e shumëpalëshe, lektorë, pjesëtarë të stafëve shkencore, pedagogë të universiteteve, që për shkak të njohurive të tyre të veçanta punojnë në Republikën e Shqipërisë, pajisen me lejeqëndrimi në bazë të kërkesës së tyre dhe konfirmimit të titullarit të institucionit qendror, në strukturën e të cilit ata janë të punësuar. Familjarët në ngarkim të tyre pajisen me lejeqëndrimi në Republikën e Shqipërisë në bazë të kërkesës së të interesuarit dhe të certifikatës familjare”.

4. Pas pikës 10 të shtohet pika 10/1 me përmbajtjen si vijon:

“Mund të pajisen me lejeqëndrimi, për motive bashkimi familjar:

- a) bashkëshorti/ja i/ e shtetasve shqiptarë, kur kërkon të banojë në Shqipëri;
- b) të afërm (nëna, babai) në ngarkim të shtetasit shqiptar dhe të bashkëshortit/es së tij;
- c) bashkëshorti/ja, fëmija(deri në moshën 18 vjeç) e shtetasve të huaj, i/e cili/a është rezident/e i/e ligjësuar në Republikën e Shqipërisë dhe kërkon të banojë në Shqipëri.

Në këto raste depozitohen aktet vijuese:

- Kërkesa e të interesuarit në Republikën e Shqipërisë;
- certifikata familjare;
- vërtetim nga gjykata se nuk ka padi të depozituar për zgjidhje martese në vendin ku gjendet rezident kërkuar i lejeqëndrimit.

Fëmijët nën moshën 18 vjeç regjistrohen në lejeqëndrimin e prindërve të tyre.

Aplikimi për bashkim familjar bëhen në komisaritet e policisë vendore.

5. Pas pikës 11 të shtohet pika 11/1 me këtë përmbajtje:

11/1 Aktet që kërkojnë për aplikim për lejeqëndrimi, të cilat janë lëshuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pranohen kur janë të legalizuara nga përfaqësia jonë, diplomatike apo konsullore, në vendin ku ato janë marrë ose nga Drejtoria Juridike dhe e Çështjeve Konsullore, në Ministrinë e Punëve të Jashtme”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta